

# PROGRAMI “PLANIFIKIMI URBAN”

## **Përshkrimi i programit:**

Ky program harton, mbështet dhe zbaton procese dhe politika për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm urban, kontrollin e territorit, administrimin e tokës, strehimin, mbetjet urbane, si dhe urbanizimin e integrimin e zonave informale; harton dhe implementon standarde në projektim dhe ndërtim, si edhe procese dhe politika për licencimin profesional, sipas fushave të përgjegjësive; harton, mbështet, financon dhe zbaton projekte në fushat e mësipërme.

## **Përshkrimi i politikës së programit:**

Politikat e këtij programi synojnë:

- Planifikim dhe zhvillim të qëndrueshëm të territorit në çdo nivel dhe në integrim me çdo sektor;
- Rigjenerimin urban dhe krijimin e modeleve të reja të zhvillimit të territorit;
- Legalizimi, zhvillimi, integrimi dhe urbanizimi i zonave informale;
- Unifikimi dhe përshtatja e standardeve urbane;
- Sigurimi i një strehimi të përshtatshëm për grupet e prekshme dhe të veçuara;
- Rehabilitimi i banesave, me qëllim përdorimin me eficiencë të energjisë.

## **Qëllimi i politikës së programit:**

Qëllimi i politikës së këtij programi është:

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale me 30%, deri në fund të vitit 2018, për garantimin e ekuilibrit midis interesave publikë dhe privatë, në zhvillimin e tokës;
- Kryerja e procesit mbi rigjenerimin urban, përmes projektsh pilot, urbanizimi dhe integrimi, për 4 zona urbane deri në fund të vitit 2018;
- Realizimi 100% i procesit të legalizimit dhe përpunimit të informacionit tekniko-ligjor, për objektet e kualifikuara, deri në fund të vitit 2018;
- Përcaktimi i standardeve të projektimit, për 6 kategori të ndërtesave publike;
- Sigurimi i një strehimi të përshtatshëm për grupet e prekshme dhe të veçuara;
- Rehabilitimi i banesave, me qëllim përdorimin me eficiencë të energjisë.

## **Objektivat e politikës së programit janë:**

1. Mbikëqyrja e procesit të hartimit dhe mbështetja teknike për hartimin e planeve të përgjithshme vendore në 26 bashki të vendit, koordinimi i procesit me grupet

e interesit dhe publikun, duke i harmonizuar këto plane me PPK, PINS Durana dhe PINS Tiranë Durrës.

2. Legalizimi dhe përpunimi i informacionit tekniko-ligjor për rreth 30.000 praktika legalizimi, pasuri informale;
3. Sigurimi i një strehimi të përshtatshëm për grupet e prekshme dhe të vecuara dhe rehabilitimi i banesave me qëllim përdorimin me efikasitet të energjisë për rreth 5000 familje
4. Sigurimi i shërbimeve bazë për realizimin efektiv të përgjegjësive funksionale të MZHU-së, për realizimin e politikave të zhvillimit urban dhe strehimit.

### **Analiza e ecurisë së shpenzimeve buxhetore**

Shpenzimet për programin “Planifikimi Urban dhe Strehimi”, në buxhetin e vitit 2017 zënë rreth 15.4% të shpenzimeve totale të MZHU. Për katërmujorin e parë 2017, këto shpenzime kanë një realizim prej rreth 21.2%, nga të cilat shpenzimet korrente rreth 33.9% dhe investimet publike rreth 4.6%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi i shpenzimeve të këtij programi paraqitet si më poshtë (në mijë lekë):

	Viti 2017			e
	Plani realizimit	Fakti katërmujori	%	
• Shpenzime korrente	975 300	330 758	33.9%	
• Shpenzime kapitale	749 974	34 267	4.6%	
• <b>Shpenzimet gjithsej</b>	<b>1 725 274</b>	<b>365 025</b>	<b>21.2%</b>	

➤ **Shpenzimet korrente** sipas klasifikimit ekonomik rezultojnë në këto nivele realizimi për katërmujorin e parë të vitit 2017:

1. Shpenzimet për paga	39.6 përqind
2. Shpenzimet për sigurimet shoqërore	38.3 përqind
3. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	23.5 përqind
4. Shpenzimet për transferta tek individët	28.7 përqind

**Investimet:** për këtë program përfaqësojnë rreth 7.6% të totalit të investimeve publike, të miratuara për gjithë MZHU-në.

Sipas zërave përbërës këto investime janë realizuar si më poshtë: (në mijë lekë)

**Viti 2017**

	Plani realizimit	Fakti katermujori	%	e
• Financim i brendshëm	556 974	23 922	4.3 %	
• Financim i huaj	193 000	10 346	5.4%	
• <b>Investimet gjithsej</b>	<b>749 974</b>	<b>34 268</b>	<b>4.6%</b>	

## INVESTIMET PUBLIKE ME FINANCIM TË BRENDSHËM:

Për programin "Planifikim Urban dhe Strehimi", janë parashikuar ne total rreth 557.0 milione leke investime publike me financim te brendeshem dhe deri ne fund te katermujorit jane realizuar ne rreth 23.9 milione leke ose rreth 4.3 perqind e planifikimit vjetor.

A. Projektet e përfshira nën këtë program, sipas institucioneve, jepen si më poshtë:

- 1. Për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit**, janë parashikuar rreth 5.0 milionë lekë per projektin "Blerje pajisje elektronike", vlere qe eshte kerkuar te rialokohet ne projektet "Pajisje zyre per AKPT" dhe "Hartimi i Planit te Detajuar per nje Zone te Rendesise Kombetare (PDZRK)".
- 2. Për Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit**, janë parashikuar 2 projekte, me vlerë totale rreth 7.0 milionë lekë, si më poshtë:
  - Projekti "Pajisje për skeleri dhe rafte arkivore" me vlerë rreth 4.0 milionë lekë,
  - Projekti "Blerje pajisje elektronike" me vlerë rreth 3.0 milionë lekë

Për dy projektet është paraqitur kërkesa për prokurim pranë MPB.

Për tre projektet është paraqitur kërkesa për prokurim pranë MPB.

### **3. Për Zhvillimin e territorit, janë parashikuar keto projekte:**

- Projekti "Rikualifikim urban i një zone rurale" në vlerën 10 milionë lekë. Është në proces te lidhjes së kontratës.
- Për projektin "Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore", me vlerë 129.8 milionë lekë. Loti 1 dhe 2 jane ne fazen e shqyrtimit te ofertave teknike, ndersa loti 3 eshte ne fazen e ankimimit ne KPP.
- TVSH për projektin "Zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i zonës bregdetare, GIZ" është parashikuar në vlerën rreth 1.0 milionë lekë. Realizimi faktik është rreth 89 mijë lekë ose 8.9%.
- TVSH për projektin ADA dhe SDC " është parashikuar në vlerën rreth      milionë lekë. Realizimi faktik është rreth
- 

### **4. Për mbetjet urbane, situata paraqitet si më poshtë:**

- Projekti "Zhvillimi i modelimeve grafike dhe përfshirja e tyre në hartën e venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane", në vlerën 700 mijë lekë. Projekti ndodhet në fazën e finalizimit të projektidesë.
- Projekti "TVSH per projektin Hartimi i master planit në fushën e mbetjeve, KFW" në vlerën 7 milionë lekë. Eshte nënshkruar marrëveshja nga KFW dhe

Ministria e Financave. Realizimi do të bëhet sipas paraqitjes së faturave për rimbursimin e TVSH-së.

## **B. Realizimi sipas produkteve**

### **1) Zhvillimi i territorit**

- a) Planet e Përgjithshme Vendore, për 7 bashki. Fondi i parashikuar për vitin 2017, prej 129.8 milionë lekë deri në fund të katërmujorit është realizuar rreth 1.8 milione leke.
- b) “Pjese te planit te veprimit te integruar per menaxhimin e zones se bregdetit, te realizuar”: është realizuar rreth 4 perqind nga 28% e pjeses se planit te planifikuar per t’u realizuar ne vitin 2017, me një fond faktik prej rreth 10.4 milionë lekë, nga 71.8 milione leke te planifikuar për vitin 2017

## **INVESTIMET ME FINANCIM TË HUAJ.**

- **Investimet publike me financim të huaj**, për vitin 2017, janë planifikuar në rreth 193.0 milionë lekë, dhe deri në fund të katërmujorit te pare te vitit ka patur nje realizim rreth 10.3 milione leke ose rreth 5.4%. Situata paraqitet si më poshtë:
  1. Për projektin “Zhvillimi i integruar dhe i qendrueshem i zones bregdetare, GIZ” jane parashikuar 70.8 milione leke dhe deri ne fund te katërmujorit te pare jane realizuar rreth 10.3 milione leke. Qeveria Gjermane nuk lëvron fonde direkt për sistemin buxhetor shqiptar, por shërbime në natyrë, për të cilat pagesat bëhen direkt nga llogaritë e donatorit.
  2. Për projektin “Hartimi i master planit në fushën e mbetjeve, KfW” jane parashikuar 46 milione leke. Eshte nënshkruar marrëveshja nga KfW dhe Ministria e Financave. Eshte firmosur marreveshja me konsulentin. Vazhdon normalisht puna.